



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2020:146504
Datë: 04.03.2021
Numri i dokumentit: 01566063

PKR.nr. 132/20

NË EMER TE POPULLIT

Gjykata Themelore ne Gjilan, Departamenti per Krime te Rënda, duke vendosur sipas kryetarit te trupit gjykues Naser Maliqi, me anetaret e trupit gjykues Veli Kryeziu dhe Kaltrina Haliti, sekretaren juridike Fikrete Destani, ne çështjen penale te te pandehurit L.U. nga f. Verban K. Viti, për shkak të veprave penale mbajtje ne pronesi, kontroll, ose posedim te paautorizuar te armeve, nga neni 366.p.1 dhe vepren penale kanosje nga neni 181 par.4 e lidhur me paragrafin 1 te KPRK-se, e sipas aktakuzes se Prokurorise Themelore ne Gjilan, Departamentni per Krimet e Renda, PP/ I. nr. 131/2020 , e dt. 30.10.2020, e pas mbajtjes e shqyrtimit gjyqsor me dt. 26.02.2021 shpalle, ndersa me date 04.03.2021 perpilon :

AKTGJYKIM

Ndaj te pandehurit L.U. nga babai M. dhe e ëma N., e lindur M., I lindur me, ne f. V., K. Viti, ku edhe banon, ka të kryer shkollën e mesme, I pa punë, I gjendjes së varfer ekonomike, I martuar, baba 3 femivjve, shqiptar, shtetas I Republikës te Kosoves.

ËSHTE FAJTOR

SEPSE

I.

Me date ..., rreth ores 20;30 minuta, ne f. S.Q., K. Viti, pa autorizim dhe pa leje valide, e ne kundërshtim te ligjit te zbatueshem per armet, ka mbajtur ne pronsi, kontroll ose posedim qrmen me gaz BOLW magnum model 200 VOLTRAN, nr. 5-51964, cal 9mm, e cila bastisjes I eshte sekuestruar nga Policia e Kosoves.

-me c'rast ka kryer veprën penale, mbajtja ne pronësi, kontroll ose posedim te paautorizuar të armëve nga neni 366.par.1.te KPRK-se.

II.

Me date ..., rreth ores 20;30 min, ne f. S.Q. e , K. Viti pas nji mosmarrveshje rreth nji borxhi, me qellim te friksimit dhe kercnimit e ekspozon dhe e repeton armen me gaz BOLW magnum model 200 VOLTRAN, nr. 5-51964, cal 9 mm, ne deme te te demtuarit K.M. me c'rast ndaj te demtuarit ka shkaktuar ankth dhe frike per jeten e tij.

-me c'rast ka kryer veprën penale kanosje nga neni 181 par.4 e lidhur me paragrafin 1 te KPRK-se

-Andaj ne bazë të nenit 4,38,39,40,42,43,46,47,48,49,50,69,70,71,72, dhe nenit 365, 450 te KPPK-së,

KONSTATON

-per veprën penale mbajtja ne pronësi, kontroll ose posedim te paautorizuar të armëve nga neni 366.par.1.te KPRK-se. I cakton denim me gjobe ne shume prej 500,00 (peseqind) euro.

-per veprën penale kanosje nga neni 181 par.4 e lidhur me paragrafin 1 te KPRK-se, I cakton denim me burg ne kohezgjatje prej 180 dite.

E GJYKON

Me denim me gjobë në lartsi prej 500,00 (peseqinde) euro, të cilin denim do ta paguaj pas kalimit te afatit prej 15 ditesh nga dita e plotfuqishmëris se këtij aktgjykimi dhe me denim me burg ne kohezgjatje prej 180 (njqind

e tetedhjetë) dite, I cili denim nuk do të ekzekutohet **me kusht** që në afat prej 1 (nji) viti mos të kryej vepra tjeter penale.

Detyrohet i akuzuari që në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej 50 (pesëdhjetë) eurove, në emër të fondit për kompensimin e viktimave shumën prej 50 (pesëdhjetë) eurove, si dhe shpenzimet gjyqësore sipas llogarisë perfundimtare.

Konfiskohet arma me gaz BOLW magnum model 200 VOLTRAN, nr. 5-51964, cal 9 mm, e cila pas plotfuqishmeris se ketij aktgjykimi

A R S Y E T I M

Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti për Krime të Renda, me dt. 30.10.2020, ka ngritur aktakuzën PP.I. nr.131/2020, ndaj të akuzuarit L.U., për shkak të veprave penale Mbrojtja në pronësi, kontrollë dhe posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 paragrafi 1 të KPRK-së dhe vepra penale kanosje nga neni 181 par4 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-se, ka kërkuar që I njejtë të shpallet fajtor dhe të denohet me denim meritor sipas ligjit.

Kryetari i trupit gjykues, me datën 26 nëntor 2020, ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar, ku është lexuar aktakuza e zgjeruar nga ana e prokurorit të shtetit dhe pas leximit të aktakuzës i pandehuri L.U. ka deklaruar se e ka kuptuar aktakuzën e lexuar, e pranon fajsinë lidhur me veprën penale Mbrojtja në pronësi, kontrollë dhe posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së, ndërsa nuk e ka pranuar fajsinë për veprën penale kanosje nga neni 181 par4 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-se.

Gjatë shqyrtimit fillestar dhe publik kryetari i trupit gjykues pas dëgjimit të të pandehurit dhe prokurorit të shtetit, ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar pranimin e fajësisë, për shkak të veprës penale Mbrojtja në pronësi, kontrollë dhe posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 paragrafi 1 të KPRK, për shkak se ky pranimit është bërë në mënyrë vullnetare dhe është në përputhje me provat që gjenden në shkresat e lëndës: raporti fillestar i incidentit, forma e konfiskimit të sendeve datë 15 shtator 2020, vërtetimi mbi bastisjen e shtëpisë dhe fotodokumentacioni.

Kryetari i trupit gjykues ka konstatuar, se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë, pranimi është bërë vullnetarisht nga i pandehuri pranimi i fajit mbështet në faktet e çështjes që përmbanë aktakuza dhe se e njëjta nuk përmbanë asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Sa I perket vepres penale kanosje nga neni 181 par.4 e lidhur me paragrafin 1 të KPRK, I akuzuari nuk e ka pranuar fajsinë për të.

Procedura e provave;

I Dëmtuari - dëshmitari K.M. ka deklaruar; se mbetet pranë deklaratave të dhënë në Polici dhe Prokurori.

Ditën kritike është e vërtetë që L.U. ka qenë tek shtëpia e tij aty kah mbramja rreth orës 19:30 apo 20:00.

Fillimisht të shtëpia e tij kanë ardhë 2 djemt EL.U., Korabi dhe një djal tjetër, por nuk ia di emrin, ka folë me këta dy djemt të cilin kanë ardh me veturë. Ata kishin ardhë me lyp një borgj prej 35.000 Euro, ndërsa tash ia kam borgj vetëm edhe 6.500 Euro, për të cilin borgj ka me ja kthy edhe atë shumë shpejt.

Pasi folëm me ata djemt, këta të fundit e kanë thirrur L. në telefon dhe ky ka ardhë pas 15 minutav.

Ky ka qenë vetëm, pastaj ka dal edhe vllau i tij B.M. dhe bashkëshortja F. L. I ka thënë pse nuk po më përgjigjesh, ndërsa ky i ka thënë, spo muj me tu përgjegj se i kam puntë keq e spo muj me ta kthy borgjin për momentin. Llaf pas llafi jemi nervozu edhe ky edhe unë, shoqja ime ka dal jashtë e më kanë shti mrena, e djali i L. dhe vllau im B. e kanë marrë L. e kanë shti në kerr.

E ka parë që dorën e ka mbajtur kah beli por nuk e di se cilën dorë.

Kur e ka parë ashtu është friguar.

Kur është nervozu L. më ka shar nanën. Revolet nuk i kam par atij, nuk i kanë thanë as gruaja as vllau, se L. ka pas diçka me vete.

Në këtë fazë të procedurës prokurori i shtetit e ballafaqon dëshmitarin me deklaratën e dhënë në prokurori më dt. 29 tetor 2020, ashtu që në faqen 2 pasusi i 6 kishte deklaruar ; **L. i ka thënë se unë të shaj përsëri, atëherë L. e ka nxjerr revolen llojin nuk e di e ka repetu ''**.

Dëshmitari deklaron: **po është e vërtetë kjo deklaratë që e kam dhënë në prokurori.**

Dëshmitarja F.M.: ka deklaruar se mbetet pranë deklaratave të dhënë në Polici dhe Prokurori.

Është e vërtetë se L.U. natën kritike ka qenë te dyert e shtëpisë tonë. Ka qenë me dy djemt e tij.

Fillimisht Kastroti ka dal dhe ka komunikuar me L.n, mandej ka dal Bejtushi vllau i K.t dhe kur e ka dëgju zhurmën ka dal edhe kjo vete, por kanë qenë do tone të ngritura tu sha tu bërtitë edhe atë L. Ukishini bërtitke.

Kjo ka qenë brenda në shtëpi dhe ka nejt brenda në dritare, sespe e ka dite edhe më herët që munet me ndodhë dicka, se L. i ka qu sms K. më herët.

L. i ka kërku paret – borgjin.

Nuk e dine saktësisht se çka ka ndodhur, se kanë folur 3-4 veta, veç zhurmën e ka ndegju, pastaj ka dal në sokak, ngase e ka ditë që edhe bashkëshorti I saje është aty.

Kur ka dal kjo, B. ka qenë duke e mbajtë L. për beli për mos me ardh drejt meje dhe K.

L. ka bërtitë lëshom por nuk e di tjetër sen çka ka thane, se ka qenë shumë e shqetsume.

Kjo ka qenë në distancë nja 10 metra nga L. dhe diçka në dorë I eshte dukur, se ka pas revole sepse ka qenë duke u terruar.

Kjo nuk ka bisedu me Bejtën se a ka pas L. revole apo jo.

Në këtë fazë të procedurës prokurori i shtetit e ballafaqon dëshmitaren me deklaratën e saj të dhënë në prokurori më 29 tetor 2020 dhe atë në faqja 2 pasusi i 5 ka deklaruar “ **L. në dorë e mbante një revole ngjyrë hiri dhe deri sa e mbante B., L. u mundonte me u liruar në tentim sulmit ndaj K.**

Dëshmitarja deklaron : **Po kjo është e vërtetë.**

Dëshmitari K.U. djali I te akuzuarit, njoftohet se ka të drejtë të mos dëshmoj për shkak të afërsis familjare, megjithatë deklaron se dëshiron të dëshmoj.

Ka mbetur pranë deklaratës së dhënë në Polici.

Është e vërtetë se ditën kritike ka qenë në Sadovin të Muhagjerëve, te dyert e K.t, aty kah mbramja duke u terruar.

Te K. ka shkuar me vllaun A. Aty kan shkuar për një borgj, sepse K. nuk na e ka qel telefonin, ka dal K. te dyert ia kena nis me fol me to, e unë i thashë pe thirri L., e kam thirr në telefon, e i njejt ka ardhë mas nja 10 minutav.

Na i tham K. pse spo na e qel telefonin, ai na tha se i kam pas do probleme skom mujt me ta qel telefonin.

Pastaj ka dal vllau i K., B. ku pastaj ka ndryshu edhe muhabeti.

K. ju ka ngërmu L., kush je ti që vjen me ma lyp borgjin edhe iu afrojke më afër. L. i ka thënë 3 herë K. kujdes, se çka je tu than paret e mia jam ardh me i lyp, ndërsa K. nuk u nalke tu bërtit por nuk e di që ka sha.

Atëherë L. u koqit dhe i ka thanë Kiastriotit, çka po të dukem unë që kam ardh me lypin borgjin tim.

Kur e ka pare që don mu acaru gjendja, e ka marr L.n e ka shti në kerr dhe kemi hec. L. nuk ka pas kurgjë në dorë, por K. që ka hyrë në oborr të vetin ka thene, pritni se çka ju kallzoi ktyne. Në momentin që jena nis na me kerr, gruaja e K.t ka dal na ka gjujtë me gur.

Bejta veq ka hyrë ndërmjet mos mi lanë mu afu.

Me propozimin e Prokurorit te shtetit dhe me pajtimin e paleve, gjykata ka lexuar deklaratën e deshmitarit B.M. e dhene ne polici me date 12.06.2020, ne te cilen kishte deklaruar se rreth ores 21 sa kishin ar5dhe prej pune nga Ferizai, ka dal jashta shtepise dhe ka pare vllaun e tij K.n duke biseduar me L.n e Verbanit, I cili kishte ardh kerre Golf gjashte, me dy djemt e tije ku njeri ishte ne veture e tjetri jasht. Ishin kan duke biseduar per nji borgj, ku K. I ka thene se ti kam borgj, por nuk te kam borgj me me sha. L.n e ka degjuar tu then se te kam share dhe te shaje, e shajti dhe situatë eshte tension. L. morri turre qe ta sulmoi vllaun K., e ka nxjerre revolen dhe e ka repetu dhe duke dashur ta drjtoi kah vllau, ky ka intervencë sbashku me djalin e L. K., ku e kan bllokuar dhe e kan future ne kerrin e tij, ku kan ikur nga vendi I ngjarjes. Revolja ishte e madhe dhe e bardhe. Nuk e din qfar lloji. Kjo situatë ka ardhë si rezultat I nji borgji qe K. ja ka L., nuk e dine shumen.

Leximin e shkresave

-Raporti fillestar i incidentit me nr. 2020 CG 209

-Raporti i oficerit

-Kallzimi penal

Ne keto shkresa eshte pershkru ngjarja ne baze te provave te mbledhura, siq jan deklarat e deshmitarve dhe te akuzuarit.

Mbrojtja e te akuzuarit;

I akuzuri L.U., ka deklaruar se ditën kritike, aty rreth mbramjes nuk i kujtohet saktë sa ka qenë ora, djali im Korabi më ka thirr në telefon dhe më ka thënë se jam te shtëpia e K.t me djalin tjetër Arbërin.

Ka shkuar pas 15 minutave.

Eshte takur me K.n, ka fol me të i ka thene K.t, pse spo ma qel telefonin, më tha po më vjen marre shkaku i borgjit nuk po kom me ti dhënë, kan biseduar rreth 5 minutav rreth borgjit dhe më tha që kur ti boj paret ti jap.

Në monentin që ka ardhë aty B.a vllau i K.t, K. më ka thënë pse më ke ardh te shtëpia. Ky i ka thënë se ka ardhë për paret e mia se skom ardh për tjetër sen.

Aty për aty është nxe situata dhe unë jam bo nervoz dhe ia kam shar nanën. Atehere I'a ka ngjit djali im K. dhe i ka thënë, pashë mu hajde hyn në kerr. Ky kam hyrë në kerr, ka shku në shtëpi. Nuk kam pas asgjë me vete.

E ndien veten fajtor që e ka sharë K.n në prezencë të grusë.

Fjalën përfundimtare të palëve;

Në fjalën përfundimtare prokurori i shtetit deklaron:

Për veprën penale të kanosjes është vërtetuar qartë se tani i pandehuri L.U. e ka kryer këtë vepër penale me armën për të cilën pretendohet, të përshkruar në dispozitivin nën II, këtë e vërtetojn më së miri dëshmitarët B.M., F.M. dhe vetë i dëmtuari - dëshmitari K.M., me veprimet e tij koknkrete duke shtënë dorën në brezin e majtë e nxjerr armën me qëllim kërcnimi duke e shqetsuar tani të dëmtuarin K.M. për një kohë të gjatë të vazhdeueshme.

Pikërisht në këto rrethana propozoj që i nejjti të shpallet fajtor dhe të gjykohet në bazë të kodit, duke marr parasysh rrethanat rënduese dhe lehtësuese.

Megenëse kanë lidhje familjare të dy palët në mes të dëmtuarit dhe të akuzuarit njëkohësisht marrëveshja dhe kompenzimit të dëmit - janë pajtuar te dytë me pretekst se nuk do të kryen vepër tjetër penale.

Bazuar në këto fakte propozoj një dënim të arsyeshëm proporcion me veprën penale.

I dëmtuari K.M. deklaron: nuk i bashkangjitem ndjekijes penale dhe nuk kërkokj kompenzim.

I akuzuari L.U. deklaron: kërkoj nga gjykata që të vendos në bazë të ligjit.

Pas analizimit te provave dhe mbrojtjes së të akuzuarit, gjykata konstaton; se I akuzuari e ka kryer veprën penale kanosje nga neni 181 par.4 lidhur me paragrafin 1 te KPRK-se. I akuzuari ditën kritike pasi ishte thirrë nga djali I tij nëpërmjet telefonit, kishte shkuar në f. Sodovine e Qerkezve te shtëpia e të dëmtuarit K.M. për ta kërkuar një borgj në të holla. Gjat bisedës që kan pas ndërmjet vedi, I akuzuari L. me të demtuarin K., është tensionuar situata ndërmjet tyre, L. I'a ka sharë nanën K.t, është vërsul nga I njejt, duke e nxjerre revolën, duke e rëpetuar, mirpo pas ndërhyrjes së dëshmitarit B.M. dhe deshmitarit K.U., këta e kan kap tani te akuzuarin L., duke e futur në veturë, e pastaj L. me djalin e tij K. jan larguar nga vendi I ngjarjës. Këto fakte jan vërtetuar nga deklarata e te dëmtuarit në cilsinë e deshmitarit, K.M., I cili e ka përshkruar se si L. fillimisht I'a ka sharë nanën, pastaj e ka nxjerrë revolën duke e repetuar, mirpo pastaj kishin ndërhyrë dëshmitarët K.U. dhe B.M. dhe e kishin larguar L.n duke e futur në veturë.

Kjo dëshmi e të dëmtuarit-deshmitarit perputhet edhe me deshminë e dëshmitarve B.M. dhe F.M., të cilët gjithashtu në mënyrë të njejtë e pershkruajn, se si L. ka nxjerre revolën, duke e repetuar dhe duke tentuar t'I afrohet tani të demtuarit K., mirpo pas nderhyrjes se K.U.t dhe B.M., L. është detzruar te hyjë ne veturë, duke e shmangur rrezikun.

Dëshmia e të demtuarit pjesrisht përputhët edhe me deklaratën e të akuzuarit L., I cili ka pranuar se ka zhvilluar një bisedë me K.n, eshte nervozuar dhe ja ka sharë nënën K.t.

Për këtë arsye gjykata ia fale besimin dëshmisë së të dëmtuarit-dëshmitarit K.M. dhe është e bindur se L.U. e ka kryer veprën penale kanosje nga neni 181 par.4 e lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së.

Duke marrë parasysh se I akuzuari L.U. akuzohet për dy vepra penale, dhe ate; **mbajtja ne pronësi, kontroll ose posedim te paautorizuar të armëve nga neni 366.par.1.te KPRK-se te cilen e ka pranuar ne séance fillestare dhe per vepren penale** kanosje nga neni 181 par.4 e lidhur me paragrafin 1 te KPRK-se, gjykata I ka caktuar denim per sejcilen veq e veq, ashtu qe per dispozitivin I. I ka caktuar denim me gjobe ne shume prej 500,00 euro, te cilin do ta paguaj pas plotfuqishmeris se ketij aktgjykimi, ndersa per vepren penale nen dispozitivin II. I ka caktuar denim me burg ne kohezgjatje prej 180 ditesh, I cili denim nuk do te

egzekutohet me kusht që në afat prej një viti mos të kryej vepra tjeter penale.

Gjatë matjes dhe shqiptimit të dënimeve, gjykata ka marrë për bazë rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit. Në këtë aspekt kryetari i trupit gjykues si rrethane lehtësuese për të pandehurin, ka pasqyruar pranimin e fajësisë për veprën penale në dispozitivin II. Në këtë aktgjykim, është penduar, ka kërkuar falje për kryerjen e kësaj vepre penale, është baba i 3 fëmijëve, i premtuar gjykatës që në të ardhmen, nuk do të përsëris vepra tjeter penale, dhe faktin se i demtuari K. nuk është bashkangjitur ndjekjes penale, nuk ka kërkuar kompensim, ka shprehë gadishmerinë që ta paguaj borxhin e mbetur.

Kryetari i trupit gjykues ka detyruar të pandehurin që kësaj gjykate t'ia paguaj shumën paushalle në vlerë prej 50 euro, si dhe 50 euro për viktimat e krimit, kurse shpenzimet e procedurës sipas llogaris përfundimtare të kësaj gjykate.

Gjykata ka konfiskuar revolen me gaz BOLW magnum model 200 VOLTRAN, nr. 5-51964, kal 9 mm, e cila pas plotfuqishmerisë së këtij aktgjykimi.

Sa i përket dëshmive të dëshmitarit **K.U.**, gjykata konsideron se i njëjti I është shmangë deklarimit të së vertetës, për shkak të afërsisë së tij me të akuzuarin L., të cilin e ka baba.

**GJYKATA THEMELORE NE GJILAN
DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA**

Më datë: 04.03.2021

**Sekretare juridike,
Fikrete Destani**

**Kryetari i trupit gjykues
Naser Maliqi**

KSHILLA JURIDIKE: Kunder këtij aktgjykimi, palet e paknaqura mund të ushtrojnë ankese në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.